



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna e Vitisë  
Opstina Vitina  
Municipality of Viti/na

## PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË DYTË TË RREGULLT TË KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA TË KOMUNËS SË VITISË

Mbledhjen e thirri dhe e kryesoi z.Naim Pira, kryesues i Kuvendit të Komunës së Vitisë. Mbledhja është mbajtur më **20.02.2020 (e Enjte)**, në Zyrën e konferencave ne objektin e ri të Komunës të, duke filluar me punë në ora 10 h. Në mbledhje morën pjesë: z.Hasan Aliu (nënkryetar i Komunës), z.Naim Pira (kryesues i Kuvendit Komunal), znj.Xhilsime Qamili, znj.Blerina Lubishtani, z.Jakup Demiri, znj.Idajete Pira, z.Bekim Azizi, z.Ekrem Abazi. Morën pjesë edhe drejtorët e drejtorive, përfaqësuesit e OSBE-së. Pasi u konstatua se prezent janë 7 anëtarë të KPF-së, andaj kishte kuorum, kryesuesi i Kuvendit e shpalli të hapur mbledhjen.

**Kryesuesi z.Naim Pira:** Përshëndetje për nënkryetarin e Komunës, të gjithë ju anëtarë të KPF-së, drejtorët që janë prezent zyrat e kryetarit, OSBE-në dhe mirë se keni ardhur në mbledhjen e dytë të rregullt të KPF-së për këtë vit. MAPL-ja naj ka kthy ligjëshmerin e vendimeve perveq rregulloren per transparencën në komunën e Vitise rregulloren që e kemi miratu mbledhjen e kaluar naj ka kthy me disa vërejtje ku nuk jan përputh disa nene ndërmjet vete do të sjellim në mbledhjen e radhës që të bejm kete ndryshim.

**Nënkryetari z.Hasan Aliu:** Pershendetje të nderuar të pranishëm, e morra fjalen per sqarim sepse ka qen që të vijet propozim rregullorja per rregullimin e orarit të punës per bizneset të kalon më kuvend dhe me kërkesën e zyrës ligjore e cila punon në kuadër të kabinetit të kryetarit ka kërkuar një afatshmeri per shkak se ka konstatu se preambula e rregullores nuk eshte në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi prandaj pershkak që nuk eshte rregullorja ketu ne kete KPF shkaktar jame unë sepse e kam mendu që me mir është të përpunohet konform dispozitave ligjore.

**Kryesuesi z.Naim Pira:** a ka dikush ndonjë pyetje jashtë rendit të ditës, atëherë për këtë mbledhje kemi paraparë këtë:

### R e n d i t e

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e pare e Komitetit për Politikë dhe Financa.
2. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për mbrojtjen e vlerës së natyrës: Trungun e Bungbutës (*quercus pubescens*) në Zhiti të Vitisë, si monument i natyrës.
3. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për mbrojtjen e vlerës së natyrës: burimi i ujit termomineral në Ballancë të Vitisë si monument i natyrës.
4. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për mbrojtjen e vlerës së natyrës: Trungjet e Qarrit (*quercus cerris*) në Binçë të Vitisë, si monument i natyrës.
5. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për mbrojtjen e vlerës së natyrës: Trungun e Qarrit (*quercus cerris*) në Gërmovë të Vitisë si monument i natyrës.
6. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për mbrojtjen e vlerës së natyrës: Pylli i Millakes (*quercus sp.*) në Sllatinë të Epërme të Vitisë, si monument i natyrës.

7. **Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për mbrojtjen e vlerës së natyrës: Kompleksi i Trungjeve të Dushkut (*quercus sp.*) në Sllatinë të Poshtme të Vitisë, si monument i natyrës.**
8. **Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për mbrojtjen e vlerës së natyrës: Guri i Blinave në Gjylekar të Vitisë si monument i natyrës**
9. **Propozim për shqyrtimi dhe miratimi e planit te punës se komitetit për komunitete për vitin 2020.**
10. **Propozim për shqyrtimi dhe miratimi e planit te punës se komitetit për pjesëmarrjen e qytetarëve në vendimmarrje për vitin 2020, dhe raporti i punës së këtij komitetit për vitin 2019.**
11. **Propozim për shqyrtimi dhe miratimi e planit te punës se komitetit për Arsim, Kultur, Rini dhe Sport për vitin 2020.**
12. **Informatë nga zyra e prokurimit mbi raportin e prokurimit dhe planifikimi final i prokurimit për vitin 2019.**
13. **Raport pune nga Zyra e Personelit për periudhën Janar-Dhjetor 2019.**

A ka dikush rrethe rendit të ditës ju lutëm fjala është për ju :

**z.Ajet Sallahu** Drejtori i drejtorisë se Urbanizmit: Përshëndetëj të nderuar të pranishëm unë kame një kërkesë kame një propozim vendim për krijimin e qasjes së parcelës nr 3760-0 ne rrugën publike me nr.2592-11 përmes parcelave me nr.2586-6 dhe nr.2582-8 ky vendim është i njëjti me at që e kemi shfuqizu ne seancën e kaluar për shkak se e kishim preambulën jo konform dispozitave ligjore tani e kemi rregullu e permisuar në preambulë baze planit zhvillimore komunal dhe plani rregullues zonës në qendër në Viti.

**Kryesuesi z.Naim Pira:** Qete në votim për miratim rendin e ditës se bashku me propozimin e dhëne nga drejtori, nga të gjithë u miratua rendi i ditës.

Si pikë të parë kemi:

1. **Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e pare e Komitetit për Politikë dhe Financa.** Hapi debat për këtë pike të rendit të ditës, pasi që nuk ka për diskutim e qes në votim për miratim nga të gjithë të pranishmit u miratua pika e par e rendit të ditës.

**Si pike të dyte kemi:**

**2.Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për mbrojtjen e vlerës së natyrës: Trungun e Bungbutës (*quercus pubescens*) në Zhiti të Vitisë, si monument i natyrës.** Këto pika të rendit të ditës e kanë edhe elaboratin mire po për shkak të materialit voluminoz i kame than zyrës së sekretarisë që të ju përcjellin në e-mail elaboratin dhe besoj që ju kanë përcjell, duke par që natyrën e këtyre pikave është e njëjtë por ne duhet ti miratojmë një nga një që ti qojmë në kuvend unë hapi debat për këto pike.

**Drejtori z.Ajet Sallahu:** Nëse është mundësia ti prezantoj të gjitha pasi që janë të natyrës së njëjtë dhe bën prezantimin e të gjithëve këtyre pikave zyrtaret e ministrisë se ambientin se bashku me zyrtaret e komunës së Vitisë i kanë vizitua të gjitha këto vende dhe kanë bërë edhe fotografi e janë shqyrtua këto propozim vendime andaj kërkoj nga ju që ti miratojmë e ti dërgojmë në kuvend për miratim.

**z.Ekrem Abazi:** Përshëndetje për të gjithë propozoj që këto pika të miratohen me një pik pasi që janë të natyrës së njëjta po shumica nga këto ishin në prona private a banë vakin psh. Me pengunajkushe këtë pjesë që nuk donë me e leju a keni bisedua me ata njerëz sepse shumica ishin në prona private, a keni ndonjë marrëveshje me ata persona.

**Drejtori z.Ajet Sallahu:** Këto fillimisht duhet me kalua si monument të mbrojtura e masanej instituti i trashëgimisë kulturore merret me këto qështje e jona është me i caktu si monomente të mbrojtura e masanje edhe gjat hartimit të planit zhvillimore duhet ti rregullojmë psh sa largësi nuk lejohet të behet ndërtimi.

**z.Bekim Azizi:** Përshëndetëj të nderuar të pranishëm a i keni përfshi krejt vendet a ju ka mbete ndonjë që nuk është përfshi, psh këtu a kanë muajt me hi edhe pjesa e pishave që janë në Terpez, Novosell, dhe Ekremi që e diskutoj të pronat private mendoj që duhet me pas kujdes këtu.

**Drejtori z.Ajet Sallahu:** Janë analizua këto dhe me iniciativën e sektorit të ambientit nuk kanë muajt mu përfshi krejt po ato që janë përfshi janë si monumente të mbrojtura.

**Kryesuesi z.Naim Pira:** Pasi që nuk ka të tjerë at her me kërkesën e juaj po i qes në votim për miratim prej pikës së dyte deri tek pika e tete, kush është që të miratohen këto pika nga të gjithë u miratuan këto pika.

**Si pike të nëntë kemi:**

**9. Propozim për shqyrtimi dhe miratimi e planit te punës se komitetit për komunitete për vitin 2020.**

Këtë komitet e kemi themelua në kuvendi komunal i Vitisë, anëtarët e këtij komiteti kanë bë planin e punës dhe para juve e kanë sjell këtë plan unë hapi debat për diskutim, pasi që nuk ka për debat qes në votim për miratim nga të gjithë u miratua edhe kjo pik e rendi të ditës.

**Si pik të dhjet kemi:**

**10. Propozim për shqyrtimi dhe miratimi e planit te punës se komitetit për pjesëmarrjen e qytetarëve në vendimmarrje për vitin 2020, dhe raporti i punës së këtij komitetit për vitin 2019.**

Edhe këtë komitet e kemi themelua në si kuvend anëtarët e këtij komiteti kanë sjell para ne planin e punës për vitin 2020 dhe raportin e punës për vitin 2019, materialin e keni para vete unë hapi debat për këtë pike, pasi që nuk ka për diskutim qes në votim për miratim nga të gjithë të pranishmit u miratua edhe kjo pik e rendit të ditës.

**Si pike e njëmbëdhjetë kemi:**

**11. Propozim për shqyrtimi dhe miratimi e planit te punës se komitetit për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport për vitin 2020.** Edhe ky komitet është themelua nga ne tani ky komitet është aktivizua dhe para neve kanë sjell planin e punës për vitin 2020 materialin e keni pranuar me kohe unë hapi debat për këtë pik të rendit të ditës:

**znj.Xhilsime Qamili:** Përshëndetje të nderuar të pranishëm, në e shprehi shqetësimin se ne funde të këtij plani thuhet me respekt Mirlinda Sadiku anëtarët e komitetit për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport këtu shqetësimi im është se ky komitet e ka një kryetar të zgjedhur Basri Sylejmani po nuk jam kundër që shkruan anëtar po këtu duhet me procedua kryetari i komitetit e ka bë këtë.

**Kryesuesi z.Naim Pira:** Pasi që nuk ka të tjerë për diskutim e qes në votim për miratim nga të gjithë të pranishmit u miratua edhe kjo pik e rendit të ditës.

**Si pike të dymbëdhjetë kemi:**

**12. Informatë nga zyra e prokurimit mbi raportin e prokurimit dhe planifikimi final i prokurimit për vitin 2019**

**z.Fadil Abazi shef i zyrës së prokurimit:** Përshëndetje të nderuar të pranishëm, e keni para vete raportin e planifikimit të zyrës së prokurimit për vitin 2020 e keni formën e tabelës që gjenerohet në sistem online dhe janë të ndarura sipas punëve që kryen dhmth me pune shërbime, furnizime informatën e keni pranuar me kohe unë jam në dispozicionin e juaj për pyetje shtesë.

**Kryesuesi z.Naim Pira:** Hapi debat për këtë pike të rendi të ditës.

**z.Ekrem Abazi:** Nuk pash askund shpenzimet kapitale as një shpenzim për ujësjellës, rrjeti a po pune shtese që janë bë për ujësjellës.

**z.Fadil Abazi shef i zyrës së prokurimit:** Kryesisht këto investime bëhen në bashkëpunim me CDI-në e kemi fondin e bashkëpunimit beto bëhen në bashkëpunim e kemi fondin e bashkëpunimi e këto nuk dalin në prokurim këto e keni tek buxheti pasi që nuk prokurohet nuk hin në planifikim.

**Kryesuesi z.Naim Pira:** Unë e kam një pyetje këtu tek pika 7 e kontratës se furnizimit është parapa furnizimi me tonet për të gjitha njësit shpenzuese 9800 euro po me intereson me dit ne e kemi një kompani e cila është obligative vetëm e kanë prur këtu një aparat për fotokopjim të materialit a është obligativ komuna me pas një kod të tillë dhe këtu një pyetje tek mirëmbajtja e ujësjellësve dhe kanalizimit ne komuna e Vitisë 51 është 27 mijë euro këtu i keni dy her dhe prap 67 mirëmbajtja e ujësjellësit dhe kanalizimit ne komunën e Vitisë 17 mijë euro a është gabim teknik.

**z.Fadil Abazi shef i zyrës së prokurimit:** Kjo është gabim teknik sepse vitin e kaluar është kanë 17 mijë planifikimi ndërsa sivjet është 27 mijë, ndërsa tek furnizimi me tonerët aty ne kuadër të AQP-së për krejt institucionet e qeveris së Kosovës është bë një kontratë shërbimi për shitje ata i bin pajisjen i bin tonerët e ne duhet me pas letrën tone e duhet me e respektua ne kontratën e AQP-së mir po na gjate diskutimeve me drejtorin e arsimit dhe disa drejtori tjera kemi pa të arsyeshme që këtë punene e tonerëve me lan si rezer për shkak se në shkolla po ju duhet tonerë ose ne rast të prishjes e operatori i ka 160 autoritete dhe ai po na le keq e unë kam propozua që çdo institucion ta këtë ka një printer rezervë psh zyra ime nuk ka qare pa pas një printer rezervë se ai nëse një javë nuk ma bijën një printer unë dështoj ne gjithëqka dështoj në dokumentacione e unë kame mëndu që zyrat që janë me të ndishëm të kenë ka një toner rezervë psh kemi pas tek ofiqari ku ai nuk najë ka prur printerët me kohe e kemi mbet keq për këtë e kam mëndu këtë.

**Kryesuesi z.Naim Pira:** Unë po pyes a është ligjore nëse te furnizimet me tonerë a kemi të drejt ne tash me bë thirrje për furnizim nëse e kemi një marrëveshje një kontratë të nshkrume me një operator që është ne Prishtinë dhe e ka për obligim me furnizu a është shkelje ligjore po me intereson me dite.

**z.Fadil Abazi shef i zyrës së prokurimit:** Jo nuk është shkelje ligjore kjo, ne e kemi shpall tenderin për 12 muaj për furnizim.

**z.Ekrem Abazi:** Po me intereson numeri rendor 14 furnizimi me material dekorues dhe dekorimin e qytetit për festat e fund vitit është 9990 euro kjo e dyta është shërbimet e mirëmbajtës se ndriçimit publik dhe dekorimi i qytetit për festat e fund vitit e njëjta vetëm që njëra është 9990 euro e tjetra 56 mijë euro. Tek ndriçimi shërbimet e zerimit për nevojat e komunës është 6460 euro, ndërsa shërbimet e zgjerimit për flakadan te karadakut 7220

**z.Fadil Abazi shef i zyrës së prokurimit:** Tek e para edhe këtu është gabim teknik a tek zerimi këtu dallojnë zerimi është kur të vjen kur të ka manifestime dhe vyen mikrofonin ndërsa tek flakadani i karadaku shërbimet e ndriçimit profesional të bindës, aksesoreve dhe zerimit tash nëse e vendosim ne një bin në park at her vjen bina, reflektori zerimi e këto nëse e shfrytëzojmë binen për jashtë e pagume nëse nuk e shfrytëzojmë nuk e pagumi.

**z.Ekrem Abazi:** Po mos po e merr dikush e fiton këtë qysh dini me bë e 7220 euro shkojnë për një imcim shume të vogël, unë po dyshoj sepse kur po e shoh 1 metër pllaka 50 euro qka po e lexoj në portale e nuk e di hala të sakt ose një sob një ogjak me tulla të prishitë me kushtu 1428 euro po me lën ment e po dyshoj që edhe kjo bëhet qashtu, unë këto qka po e lexoj po del materiali shume i mirë edhe të varrezat e dëshmorëve e pash që ment me lan edhe qaty me vjedh unë po flas bazë shënimeve që i kam pa.

**z.Fadil Abazi shef i zyrës së prokurimit:** A to që po i thua ti janë dizinformata shume të kollume po me vjen keq që keni ra në ndikimin e këtyre, te varrezat e dëshmorëve që janë renovu at e ka udhëheq agjencioni memorial e nëse e ki për pastrimi e varrezave as një vorrez në komunën e Vitisë nuk është pastrua dhe nuk është pagua.

**Kryesuesi z.Naim Pira;** Informata e planifikimit të prokurimit për vitin 2020 na ka ardh me gabime që po shihen unë kisha sugjerua që një informatë e tillë të përgatitet dhe të na vjen në mbledhjen tjetër të

KPF-së nëse jeni të mendimit edhe ju unë e qes në votim kush është që ky dokument të na sjellët për seancën e radhës, nga të gjithë u votua që ky dokument të permisohe dhe të sjellët në mbledhjen e ardhshëm.

**z.Bekim Azizi:** Unë mendoj që duhet me na ardhe edhe informata e vitit 2019 raporti mbi kontratat e nënshkruara se nuk e kemi pa as ka qen dashur me na ardhe ajo para kësaj, disa kontrata që janë në wep të komunës nuk po qelën e disa nuk i kanë qit hiq aty, Fadil ne nuk bimë në ndikim hiq mos u bën merak ti nëse unë e marr në wep faqe kontratën për mirëmbajtje të varrezave të cilën kontratë e ke nënshkrua ti me operatorin per miremnajtje të varrezave ku i kemi ne kontrat të cekur cilet varreza edhe qmimin edhe nëse e marr kontratën e nënshkruar prej teje e ta publikoj e thamë që ku është kontrata as një vorrez nuk është mirëmbajt dhe bazë kësaj ti ki vjedh sepse ti e ke nënshkrua kontratën bazë kësaj që ti thave na kemi rrejt unë po thamë që bazë kësaj unë po thamë tash që ti ki vjedh unë e di që 400 mije euro gurtë që janë bë aty ti ki vjedh e di që 100 mije euro që e ki bë matjen gjeodezike që e ki bë tek lumi Morava unë e di që edhe aty ki vjedh, edhe një ne seancën e radhës bire kontratën që e ke nënshkrua për këtë objekt ku jemi ne tash edhe pranimi teknik se qfar kontrate ke bë qka ke nënshkrua qka kanë pranua e këshyrmi dhe kurgja

**z.Fadil Abazi shef i zyrës së prokurimit:** Unë kur ti bi këto informata ti duhesh me me kërkua falje publike, unë ti bij faktet krejt edhe ti kërkon falje, nëse një pagës është e pagume për pastrim të varrezave në komunën e Vitisë un qohem jap dorëheqje nuk rri ma.

**z.Bekim Azizi:** Bire informatën arsyetohu e nëse e arsyeton unë krejt qka kam shkrua për ty të kërktoj falje.

Si pike të tremëdhjet.

### **13. Raport pune nga Zyra e Personelit për periudhën Janar-Dhjetor 2019.**

**z.Hysen Ymeri Shef i zyrës së personelit:** Përshëndetj të nderuar të pranishëm para se me kalua tek informata unë po du me ju than si koleg e si jurist unë mos lajmërimi i veprës penale është vepër penale nuk po du me bë reagim kërktoj këtu po ata që kanë informacione të tilla në rastin konkret Bekimi që e tha dhe qytetaret e thjesht është mirë me bë një dosje e me shku drejt e në prokurori publike edhe me shku me e donecu, e këto që thuhet nuk janë në rregull edhe unë jam për me i luftu dukurit negative. Te nderuar anëtar të komitetit për politik dhe financa para vete e keni informatën e cila përmban aktivitete që i ka zhvillu njësia e personeli për periudhën janar – dhjetor 2019, nuk po hi në detaje unë po jam në dispozicionin e juaj për pyetje.

**Kryesuesi z.Naim Pira:** Hapi debat për këtë pike të rendit të ditës.

**z.Jakup Demiri:** Unë kame vërejtje tek drejt shkrimi paska shume gabime me e leshu këtu dokument që paska shume gabime, edhe këtu një pozit zyrtar për rrejet dhe matje këtë nuk po e kuptoj tek drejtoria e inspeksionit

**z.Hysen Ymeri Shef i zyrës së personelit:** Gabim teknik është ai sepse duhet të jete zyrtar për rrjet dhe matje.

**z.Ekrem Abazi:** Si shef i personelit a të erdhi vështir kur të tha me i anulua 4 konkurse

**z.Hysen Ymeri Shef i zyrës së personelit:** Për cilët konkurse e ki fjalën që janë anulua, unë e kame për obligim me i përcjell procedurat e rekrutimit pozita me marrëveshjen të veçantë qofte të rregullta unë e përcjelli procedurën ligjore bazë ligjit dhe tjerat ndikimet poshtë e përpjetë unë këtu hiq nuk i shti në vesh është komisioni përkatës i cili themelohet nga kryetari i komunës prej 5 anëtarëve profesionalist të fushës së caktuat, rregullorja për procedurën e rekrutimit e thotë tekstativisht në rast se herën e pare nuk janë së paku tre kandidat të cilët i plotësojnë kushtet e barabarta at her konkursi anulohet, konkursi publik që është anulua për psikologët është anulut sepse nuk kanë qen tri kandidate ose tre kandidat bane ju keshilltaret komunal një komisioni ejani keni qasje ne dokumente zyrtaret ti jap të gjitha unë nuk i iku punës time, keto që i kame sot me vet janë letra janë dokumente, me akuzua nëpër facebooka unë i thirri

edhe VV,PDK,AAK,LDK, ju bej ftes publike edhe kreyve qytetarëve të komunës së Vitisë hajdni tek unë merrni letrat në momentin që gjani një dokument ose një dosje që është anti ligjore unë shkoj të shpija, formone komisioni në kuadër të kuvendit merrni letrat shikone a kam gabua dikune nëse po qonem në prokurori unë vi bashk me ju vetëm qatë dit që një këshilltar i kuvendit komunal ose një zyrtar i administratës komunale mu mi qon ato pa argumente me mu i del pune ti e din që unë jam marka në letra sikur që ju ka dal atyre dostave të ju dhe të mi tash po duhet komuna me mi dhanë nja 50-60 mije euro mu që më ka maltretu me mu maltretime nuk ka tek unë ka drejtësi urdhëroni i qesim letrat sa kam muajt maksimalisht kam bë përpjekje që njerëzit profesioniste dhe unë konsideroj shume që njerëzit kanë ardhe profesional vetëm këshyrni sekretaret e shkollave kane tituj akademik magjistra.

**z.Jakup Demiri:** Sekretari i shkollës në Smirë qysh ka ardhe.

**z.Hysen Ymeri Shef i zyrës së personelit:** Unë e kame dosjen e sekretarit të shkollës së Smirës me veti ju ka bë e pa drejte sekretari i shkollës së Smirës është magjistër i shkencave juridike eja shikoj letrat,

**z.Jakup Demiri:** Sekretari i shkollës në Smirë ja kanë ndalu 50 me tra me ju ofrua shkollës.

**z.Hysen Ymeri Shef i zyrës së personelit:** Kur kush ja ka ndalu ne nuk po e dijshti këtë mos bani hajgar, nëse Astrit Shabiu sekretari i shkollës së Smire eja ne dy para burrave japim fjalën që unë po thamë që Astriti është jurist i diplomuar.

**z.Bekim Azizi:** Një pyetje psh të konkurset me shërbime të veçantë këto drejtori ti sjellin ty kërkesat për nevojat që i kanë e me këtë po lidhem këta që po i shohim që po pranohen zakonisht janë ata që janë kane vitin e kaluar vetëm këta po i plotësojnë kushtet me shume e po kanë mundësi me hi a po vetëm po del konkursi me ju përshtat atyre unë e besoj që e ki udhëheq mirë procedurën me letra e ke mbulu.

**z.Hysen Ymeri Shef i zyrës së personelit:** Procedurat i udhëhiqi unë për vendimmarrje është komisioni janë ligjet, ligji mbi administratën publike, ligji mbi pagat, ligji për vetëqeverisje lokale, ligji për shërbime civil, ligji i punës, rregullorja për procedurat e rekrutimit, ligji mbi mardhënjët detyrimeve fjala është për kontrata me marrëveshje të veçantë këtu janë njerëz specialist të fushës dhe drejtoria përkatëse e cila është e obliguar bashk me njësinë e personelit në momentin kur e sheh që ka nevojë sepse pozitat e përhershme nuk kemi buxhet për mi marr ku ish kanë fatin me marr njerëz me i shti në pune psh te drejtoria e administratës ne ofiqari e dini situatën qyshe e kemi gjat verës kur të vin diaspora mirën njerëzit që kanë një provoj aty pari me nga 4-5-6 muaj dhe kur ka mundësi diku prej juristeve ose ekonomisteve me ju bë një provoj e cila do të ju ndihmon ne të ardhëm për me shku me tutje ose rastin me zjarrfikës e kemi situatën gjat verës ose për ruajtjen e pyllit, ne kreyt këto i bëjmë duke i respektuar ligjet dhe rregullore që e rregulloj procedurën e rekrutimit, po psh kreyt ne komunën e Vitisë i kemi tre arkitektë.

**Kryesuesi z.Naim Pira:** Ju faleminderit që najë ke sjell këtë informatë.

**Si pik të fundit të rendit të ditës kemi:**

**14. Propozim vendim për krijimin e qasjes së parcelës nr 3760-0 ne rrugën publike me nr.2592-11 përmes parcelave me nr.2586-6 dhe nr.2582-8**

Drejtori në fillim na tregoj për këtë propozim vendim a jeni që ti rekomandohet kuvendit edhe kjo pike me votat e të gjithëve shkon për ne kuvend edhe kjo pike

Mbledhja përfundon në ora: 11:35

**Procesmbajtësi:**  
**Fatlum Demiri**

---

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal të Vitisë**  
**z. Naim Pira**

---